

VENDIM

Nr. 55, datë 21.1.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I NËNKALIMIT TEK URA E DAJLANIT-RRUGA E PLAZHIT DHE NËNKALIMIT NË PLEPA DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i nënkalimit tek Ura e Dajlanit-Rruga e Plazhit dhe nënkalimit në Plepa Durrës”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall nën objekt dhe objekt, me një vlerë të përgjithshme prej 100 865 609 lekë (njëqind milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 100 865 609 (njëqind milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntë) lekësh, e cila do të përballohet nga fondi i shpronësimeve në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e fundit, të nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për vitin 2015.

6. Shpronësimi të fillojë në datën 24.1.2015.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë

Bashkisë Durrës.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

TABELA PËRMBLEDHËSE

			Sipërfaqe banese m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera	Shënime
Agim Kura	8514	5/13	11	70,093	771,023	saktësim dokumentacioni
Demir Ramilli	8516	1/6	64.31	70,093	4,507,681	saktësim dokumentacioni
Gjergji Buca	8516	1/214	44	70,093	3,084,092	saktësim dokumentacioni
Aferdita Myzeqari	8518	53/50ND	17.34	70,093	879,606	saktësim dokumentacioni
Kujtim Subashi	8518	55/65/ND	39.1	70,093	1,983,426	barrë hipotekore
Jasin Jaho	8518	55/58	73.2	70,093	5,130,808	barrë hipotekore
Kujtim Subashi	8518	55/64	46.8	70,093	3,280,352	barrë hipotekore
Zdrafko Filoqi	8518	55/102	288	70,093	20,186,784	barrë hipotekore
Emine Xhafa	8518	54/101ND	31.6	70,093	1,602,973	saktësim dokumentacioni
Beqir Ramazan Kavaja	8518	9/334 (27/221)	121	70,093	8,481,253	saktësim dokumentacioni
Islam Kapllan Cela	8518	9/32	175	70,093	12,266,275	saktësim dokumentacioni
Lek Nik Gjoka	8518	27/16	273	70,093	19,135,389	saktësim dokumentacioni
Bujar Tofik Rremilli	8518	39/161	170	70,093	11,915,810	saktësim dokumentacioni
Dorian Sadik Shiqerukaj	8518	39/306	109	70,093	7,640,137	proces gjyqësor
TOTALI			1463.35		100,865,609	